



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE, E VERIFIKIMIT DHE INTEGRIMIT

+ 2981
Nr. 7490 Prot.

Tiranë, më 20.11.2020

Të dhëna mbi vendimin e APP Nr. 75, datë 20.11.2020

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 13/3/a të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar, me Vendimin Nr. 35, datë 24.07.2020, APP ka vendosur të përjashtojë për 15 (pesëmbëdhjetë) muaj operatorin ekonomik "Dule" Shpk, me NIPT J82401502P, nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, për keqinformim dhe dorëzim të dokumentave, që përmbajnë të dhëna të rreme.

I. Arsyet e heqjes së emrit të operatorit ekonomik nga lista e operatorëve ekonomikë të përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik.

Kundër vendimit Nr. 35, datë 24.07.2020, të APP, "Dule" Shpk, me NIPT J82401502P, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar shfuqizimin e këtij vendimi.

Me vendimin Nr. 2800 (08-2020-2830), datë 05.11.2020, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur pranimin e kërkesë padisë dhe dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm.

Në nenin 317 të KPrC parashikohet që "...Vendimi mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm edhe kur nga vonesa e ekzekutimit, paditësi mund të pësojë dëme të rëndësishme, që nuk mund të vihen në vend, ose kur ekzekutimi i vendimit do të bëhej i pamundur, ose do të vështirësohej së tepërmi. Në këtë rast gjykata mund të kërkojë që paditësi të japë një garanci".

Në nenin 510/a të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: "Janë tituj ekzekutivë: a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, **vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë**, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm".

Në këto kushte, APP, në mbështetje edhe të nenit 180, pika 1, gërma "b" të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", ka proceduar me heqjen e këtij operatori ekonomik nga lista e operatorëve ekonomikë të përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, që publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, si dhe në faqen zyrtare të APP, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga Gjykata Administrative e Apelit.